



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1091/1 Prot.

Tiranë, më 14.07.2025

V E N D I M

Nr. 163, Datë 14.07.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 249, datë 03.12.2024¹, e paraqitur nga znj. A.A kundër ZVAP Tropojë, Drejtore znj. Sh.B me pretendimin për diskriminimin për shkak të “përgjegjësisë prindërore²”, “gjendjes familjare dhe sociale” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 05.12.2024, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “ZVAP Tropojë, përfaqësuar nga znj. Sh.B, ka kryer akte që mund të konsiderohen diskriminuese dhe të motivuara nga hakmarrja personale ndaj meje, për shkak të kallëzimeve që kam paraqitur kundër saj, pranë institucioneve përkatëse si: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Prokurori dhe Gjykatë.

Mospublikimi i vendeve të lira të punës në portalin zyrtar është në kundërshtim me ligjin nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar”, i cili përcakton që të gjitha vendet vakante për mësues duhet të publikohen në mënyrë transparente përmes portalit “Mësues për Shqipërinë”, dhe znj.

¹ Plotësuar me informacionin e dërguar me e-mail-in datë 05.12.2024.

² Si prind i 7 fëmijëve, disa prej të cilëve kanë nevoja të veçanta shëndetësore.

³ Për shkak të ankesave dhe kallëzimeve të bëra pranë KMD, Prokurori, Gjykatë.

Sh.B nuk ka respektuar këtë procedurë ligjore. Kjo e ka privuar znj. A.A nga mundësia për të aplikuar për pozicione të tjera pune në mënyrë të barabartë dhe transparente.

Mungesa e njoftimit zyrtar në përputhje me procedurat administrative është në kundërshtim me nenin 56, të Kodit të Procedurave Administrative dhe znj. A.A nuk është njoftuar zyrtarisht dhe në kohë për detyrimet e saj. Email-i i dërguar nga ZVAP Tropojë me datë 10.09.2024, pas orës 16:25, për tu paraqitur në shkollën “Hoxhë Zogu”, mëngjesin e datës 11.09.2024, në orën 8.00, nuk i është adresuar me emër dhe ka përdorur një gjuhë të papërshtatshme, duke mos respektuar dinjitetin e saj profesional.

Në email-in e dërguar, thuhet se “nëse nesër në orën 8, nuk je në shkollën “Hoxhë Zogu”, do të konsiderohet braktisje e vendit të punës”. Ky formulim përbën presion dhe shkel nenin 32 të Kodit të Punës, i cili ndalon çdo formë presioni dhe trajtimi që cenon integritetin profesional dhe dinjitetin e një punonjësi.

Vendimmarrja për caktimin e znj. A.A në një shkollë të largët, pa kushte infrastrukturore dhe pa transport publik, bie në kundërshtim me nenin 32, të Ligjit 9367/2005 “Për Arsimin Parauniversitar”, i cili përcakton se punëmarrësit duhet t’u sigurohen kushte të përshtatshme pune, përfshirë transportin, kur shkolla është në zona të largëta.

Me e-mail-in datë 21.11.2024, drejtuar ZVAP Tropojë dhe institucioneve të tjera, jam ankuar për emërimin në shkollën “Hoxhë Zogu”, duke theksuar kushtet e pafavorshme të punës dhe diskriminimin për shkak të situatës sime familjare dhe sociale, por nuk kam marrë përgjigje nga ZVAP Tropojë.

Sipas informacionit që kam mbledhur, në shkollat: Llugaj, Cërnice dhe Pac, ka pasur pozicione të lira për mësues të edukimit fizik, për vitin mësimor 2024-2025.

Duke më emëruar në një pozicion kaq të largët dhe në kushte të papërshtatshme pune, znj. Shote Basha më ka diskriminuar, në bazë të nenit 1, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili ndalon çdo formë diskriminimi në vendin e punës, përfshirë vendimmarrjet arbitrare ose trajtimin e pabarabartë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe emërimin në një shkollë më të afërt dhe të përshtatshme, me situatën e saj familjare dhe shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1615/1, datë 10.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga ZVAP Tropojë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi, kontrata pune, etj).
 - Informacion dhe kopje të akteve të publikimit të të gjitha vendeve të punës për mësues të edukimit fizik, për vitin shkollor 2024-2025, të ZVAP Tropojë.
 - Kopje të vlerësimit të dosjeve dhe renditjes së mësuesve të profilit edukim fizik, për vitin shkollor 2024-2025, të bërë nga ZVAP Tropojë.
 - Informacion dhe kopje të aktit të njoftimit për përzgjedhjen e vendit të punës, të të gjithë kandidatëve/mësuesve jashtë portalit, për vitin shkollor 2024-2025.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit lidhur me emërimin e mësuesve të lëndës së edukimit fizik, në shkollat që mbulon ZVAP Tropojë për vitin shkollor 2024-2025 (numri i mësuesve të emëruar dhe aktet e emërimit).
 - A ka aktualisht pozicione të lira pune si mësues të lëndës së edukimit fizik? Nëse po, të vihet në dispozicion informacioni lidhur me shkollat ku janë këto pozicione.
 - Kopje të ankesës së bërë nga znj. A.A, drejtuar ZVAP Tropojë dhe përgjigjeve të dhëna nga institucioni (nëse ka).
 - Informacion lidhur me pretendimin e largësisë së vendit të punës së ankueses. Si rregullohet transporti i mësuesve në ZVAP Tropojë dhe specifikisht në shkollën Zogaj?

Me shkresën nr. 322/1, datë 24.12.2024, ZVAP Tropojë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Shkaku i parë diskriminues i pretenduar nga pala ankuese: - Mospublikimi i vendeve të lira, duke bërë që ankuesja të mos aplikojë për vende të tjera në mënyrë transparente.*

Bazuar në ligjin nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, në nenin 43 drejtori, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, cakton ngarkesën mësimore të mësuesve dhe merr miratimin e ZVAP-së për këtë ndarje.

ZVAP Tropojë ka shpallur çdo ngarkesë mësimore e cila është identifikuar nga drejtorët e institucioneve arsimore dhe ka kryer procedurat e njoftimit të kandidatëve të Portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe kandidatët jashtë portalit, sipas rregullave dhe përcaktimeve të Udhëzimit të MAS, nr. 8, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Për secilin vend pune është kryer procedura e përcaktuar e njoftimit të kandidatëve dhe janë punësuar mësuesit sipas meritokracisë dhe transparencës. Për vende të cilat ankuesja pretendon se nuk janë shpallur, theksojmë se aktualisht në ZVAP Tropojë nuk kemi njoftime nga drejtuesit e shkollave në juridiksion, për vende të lira profili: edukim fizik. Vendet ta cilat janë identifikuar si të lira janë shpallur, janë zhvilluar procedurat dhe janë punësuar kandidatët. Theksojmë se një prej tyre është dhe znj. A.A, e cila është candidate jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Shkaku i dytë diskriminues i pretenduar nga pala ankuese: - Njoftim për vend pune në drejtim të palës ankuese është me një gjuhë të papërshtatshme, duke mos respektuar dinjitetin e saj profesional.

ZVAP Tropojë kundërshton me fakte dhe në mënyrë eksplicite këtë shkak të pretenduar, pasi sqarojmë KMD-në, se ky është njoftim për vend të lirë pune, është njoftim standard që përdoret nga të gjitha ZVAP-të në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Është njoftimi që i ka shkuar të gjithë kandidatëve të Portalit dhe jashtë portalit dhe asnjë nga kandidatët deri më sot, nuk ka përdorur formulimin standard, si formulim diskriminues madje më tepër, deri në shkëlqen e dinjitetit personal të kandidatit. (bashkëlidhur njoftime të ndryshme për secilin profil të punësuar)

Shkaku i tretë diskriminues i pretenduar nga pala ankuese: - Vendimmarrja për të punësuar znj. A.A në një zonë të largët, është shkak diskriminimi.

Kërkojmë nga ana e KMD, që të njihet me Udhëzimin e MAS, nr. 8, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”. Ky udhëzim përcakton dhe procedurën e punësimit të kandidatëve për mësues nga portali dhe jashtë portalit. Kriteri bazë i punësimit është renditja e kandidatëve, pasi sipas udhëzimit kjo garanton punësimin sipas meritokracisë. Në udhëzim nuk ka të përcaktuara kritere të tjera përveç renditjes, që mund të ndikojnë në punësimin e kandidatëve (si kërkon ankuesja, që të merret parasysh gjendja e saj familjare).

Transporti i mësuesve rregullohet sipas VKM nr. 119, datë 01.03.2023, si më poshtë:

Pika 3. DRAP dhe ofruesit e arsimit profesional publik prokurojnë me fonde publike shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, sipas linjave në përbërje/pjesë të rrjetit të linjave të transportit rrethqytetas, të miratuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Pika 4. Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit rrethqytetas, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga DRAP, me autorizimin e kësaj të fundit, ZVAP-ja siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të IAP-së publike përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, të kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë të IAP-së publike, përfitues ose nëpërmjet shërbimit postar, vetëm për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, deri në përfundim të vitit buxhetor. Ndërsa tarifat e transportit rrugor janë sipas Vendimit nr. 92, datë 21.02.2024 sipas distancave në kilometra (km) ”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 30.12.2024, është njohur me përgjigjen e ZVAP Tropojë.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga ZVAP Tropojë, ankuesja me email-in datë 30.12.2024, informoi si vijon: “Sipas ligjit nr. 69/2012, neni 57, ZVAP Tropojë kishte për detyrim të publikonte të gjitha vendet e lira, duke i bërë transparente për të gjithë kandidatët e interesuar, përfshirë edhe ankuesen znj. A.A. Nuk ka prova konkrete që të konfirmojnë publikimin e këtyre vendeve në kohën dhe mënyrën e duhur. Mungesa e transparencës është një shkelje e parimeve të barazisë dhe meritokracisë. Përmbajtja e njoftimit të dërguar nga ZVAP Tropojë, nuk merr parasysh rrethanat e veçanta të ankueses dhe përgjegjësitë e saj familjare.

Caktimi në një zonë të largët pa vlerësim të përgjegjësive prindërore të ankueses, krijon një pabarazi të padrejtë dhe bie ndesh me parimet e barazisë”.

Me email-in datë 21.02.2025, subjekti ankues në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: “Më është dhënë një ngarkesë mësimore prej 11 orësh në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) dhe 11 orësh në Arsimin e Mesëm të Lartë (AML). Megjithëse mbuloj të dy ciklet me orë të barabarta, emërimi dhe pagesa ime bëhet vetëm për AMU, duke më shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë financiar dhe profesional. Në kontratën time nuk përcaktohet qartë nëse jam mësuese e AMU apo AML, duke krijuar një situatë të paqartë dhe të pasigurt për statusin tim profesional dhe të drejtat e mia financiare. Ndërkohë, në AML paguhen mësues jashtë profili, ndërsa unë, që jam në profilin e duhur, diskriminohem duke mos u emëruar në AML dhe duke mos u paguar në përputhje me normën e plotë të punës që kryej.

Ky trajtim i diferencuar është i padrejtë dhe përbën diskriminim të hapur, pasi:

1. Mësues të tjerë me të njëjtën ngarkesë orare në AML paguhen sipas ciklit të duhur, ndërsa unë jo.

2. Mësues të tjerë që janë jashtë profili emërohen dhe paguhen në AML, ndërsa unë, që kam kualifikimin e duhur, nuk emërohem dhe nuk paguhem në AML”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 361/1, datë 04.03.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 12.03.2025⁴, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesja znj. A.A, dhe përfaqësuesit me autorizim nr. 61/1, datë 11.03.2025, të ZVAP Tropojëve, z. D.I.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, si dhe deklaroi se: “Jam nënë e shtatë fëmijëve të mitur, prej të cilëve katër janë me probleme shëndetësore, përveç të tjerave edhe bashkëshorti vuan nga hepatiti B dhe kërkon trajtim të vazhdueshëm. Si pasojë e një pozicioni që kam mbajtur në ASHK Tropojë, jam përballur me disa kallëzime, të cilat më kanë dëmtuar buxhetin familjar. Pretendoj dhe diskriminim për çdo shkak tjetër, për shkak të kallëzimeve që kam bërë kundër ZVAP Tropojë.

Sipas informacionit që kam, ka vende të lira në shkollat “Oso Dauti”, Llugaj dhe “Lekë Çokaj”, Cernicë, ku mësimi i edukimit fizik zhvillohet nga mësues jashtë profili. Mësuesja e emëruar në shkollën “Murat Paci”, Pac, nuk është paraqitur në shkollë dhe orët e mësimi janë shpërndarë tek mësuesit e tjerë. Për publikimin e vendeve për mësues, kam marrë dijeni nga facebook-u i ZVAP Tropojë, dhe brenda natës janë fshirë publikimet, dmth kur kam shikuar se nuk janë shpallur vendet e lira, i kam bërë email që do bëj kallëzim.

ZVAP ka shpallur vetëm dy vende të lira për mësues të edukimit fizik, ndërkohë që mësuesja e shkollës “Oso Dauti”, është jashtë profili. ZVAP është në dijeni që kjo mësuese nuk plotëson kriteret, sepse ka dosjet e të gjithë mësuesve, si dhe bën pagesën e tyre sipas kualifikimeve. Mësuesja që ka 19 vite që jep lëndën e edukimit fizik, mund të sistemohej në shkolla të tjera sipas kualifikimit që ka.

Lidhur me pagesën që paguhem si mësuese e AMU, kam bërë ankesë në shkollë dhe në ZVAP dhe nuk kam marrë përgjigje”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ZVAP Tropojë, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe në mes të tjerash deklaroi se: “Bazuar në ligjin për arsimin parauniversitar dhe udhëzimet përkatëse, ankuesja mund të punësohet si mësuese jashtë portalit, sepse nuk ka licencë për ushtrimin e profesionit. Nga ana e komisionit,

⁴ Seanca e planifikuar për tu zhvilluar në datë 05.03.2025, për arsye objektive u shty për tu zhvilluar në datë 12.03.2025.

ankuesja është vlerësuar me 2.1 pikë dhe është renditur e dyta. ZVAP Tropojë ka pasur dy vende të lira për edukim fizik, në shkollat “Hoxhë Zogu”, Zogaj dhe “Murat Paci”, Pac. Në shkollën Pac ka shkuar E.P, e cila është vlerësuar me 5.5 pikë dhe ka licencë për ushtrimin e profesionit dhe ka qenë në pritje të renditjes në portal. Kërkesa për shpalljen e vendeve të lira bëhet nga drejtuesit e shkollave. ZVAP Tropojë ka shpallur njoftimin për vendet e lira, në faqen facebook dhe në mjediset e ZVAP-së, në datë 03.09.2024.

Mësuesja e edukimit fizik në shkollën “Oso Dauti”, ka 19 vite që jep mësim aty dhe është me shkollë të mesme pedagogjike dhe vendi i punës nuk është shpallur asnjëherë.

Mësuesja e shkollës “Murat Paci”, pas fillimit të punës ka marrë lejen e lindjes, dhe ka vajtur një mësues tjetër, por ajo mund të kthehet në punë pas lejes së lindjes.

Emërimet e punës për mësuesit jashtë portalit, bëhen vetëm me kontratë pune nga shkolla, ndërsa kur mësuesi shpallet fitues nga portali, emërimi bëhet nga ZVAP.

Lidhur me pagesën e ankueses, informojmë se paguhet si mësuese e AMU, sepse drejtori i shkollës e ka sjellë me listë pagesën e mësuesve me AMU.

Lidhur me transportin e mësuesve, informoj se nga prokurimi i këtij shërbimi nuk ka pasur fitues, dhe pagesën për transportin, mësuesit e marrin në bankë për çdo muaj. Asnjë shkollë në ZVAP Tropojë nuk ka transport për mësuesit”.

Në vijim të seancës dëgjimore, ZVAP Tropojë me shkresën nr. 61/3, datë 21.03.2025, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Sa i përket pikës së pagesës së znj. A.A, ZVAP Tropojë në bashkëpunim me drejtuesin e shkollës ka vendosur që të paguhet me orët siç i zhvillon në ciklet përkatëse, gjysëm në AMU dhe gjysëm në AML dhe do të rimbursojë pjesën e periudhës së kaluar”.

- Me shkresën nr. 361/4, datë 14.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ZVAP Tropojë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues të bëra me email-in datë 21.02.2025, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion mbi mësuesit që mbulojnë lëndën e edukimit fizik në shkollat “Oso Dauti” Llugaj dhe “Lekë Çokaj” Cernicë dhe kopje të dosjes personale të mësuesve.
 - Kopje të plotë të dokumentacionit të vlerësimit të dosjeve të mësuesve të profilit edukim fizik, për vitin shkollor 2024-2025 (E.P, R.N, znj. A.A), të bërë nga ZVAP Tropojë.
 - Shpjegime dhe bazën ligjore në të cilën mbështetet ZVAP Tropojë, lidhur me mos hartimin e një akti emërimi për znj. A.A, si mësuese jashtë portali në shkollën “Hoxhë Zogu”.
 - Shpjegime se përse znj. A.A nuk trajtohet financiarisht si mësuese në AML.
 - Informacion dhe kopje dokumentacioni për mësues të tjerë që janë në kushte të njëjta me ankuesen dhe trajtohen financiarisht si mësues të AML.
 - Kopje të plotë të procedurave të ndjekura nga Inspektorati i Punës, lidhur me trajtimin e ankesës së znj. A.A për trajtimin financiar (procesverbal, vendimin, etj).

- Informacion dhe kopje dokumentacioni për mësues të tjerë që janë në të njëjtat kushte apo të ngjashme me ankuesen, se si janë paguar ato, si mësues të AMU, AML, apo me pagesë mikse AMU+AML.
- Informacion nëse ka mësues të tjerë që trajtohen financiarisht me pagesë mikse (AMU+AML).
- Informacion për zbatimin e vendimit të Inspektoriatit të Punës, për znj. A.A.

ZVAP Tropojë me shkresën nr. 36/5, datë 24.04.2025, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Znj. A.A është punësuar si mësuese e lëndës së edukimit fizik, në mungesë të kandidatëve të Portalit “Mësues për Shqipërinë” 2024. Znj. A.A nuk plotëson kushtet e parashikuara në nenin 57, të Ligjit nr. 69/2012. Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga Komisioni për Vlerësimin Psiko-social të punonjësve arsimorë dhe punonjësve të tjerë, në institucionet arsimore parauniversitare. Ankuesja nuk disponon Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit të lëndës edukim fizik, si dhe nuk është kandidate e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Ankuesja është punësuar si kandidate jashtë portalit, sipas renditjes së publikuar, të pa ankimuar brenda afateve dhe në përputhje të së cilës kandidatja me vullnetin e lirë dhe të plotë, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, Kodit të Punës dhe legjislacionit arsimor në fuqi, ka nënshkruar aktin e punësimit dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore në bazë të këtij akti punësimi.*

Në vijim të kësaj marrëdhënie, ankuesja ka ngritur pretendime, të cilat nuk janë të parashikuara në kushtet e përcaktuara dhe të rëna dakord me palën në kontratën e punës.

Ankuesja kërkon akt emërimi për të cilin institucioni nuk mund ta përmbushë pasi është pretendim që nuk gëzon mbrojtje ligjore. Ankuesja do emërohet kur të jetë kandidate e portalit dhe të përzgjedhë vendin e punës, sipas renditjes dhe të vlerësohet për periudhën e provës.

- Informacion mbi mësuesit që mbulojnë lëndën e edukimit fizik në Shkollat “Oso Dauti”, Llujaj dhe “Lekë Çokaj”, Cërnice dhe kopje të dosjes personale të mësuesve.

Në kuadër të kërkesës ju sqarojmë se, lëndën e edukimit fizik në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Oso Dauti”, e jep mësuesja Gj.C me arsim të mesëm pedagogjik, e cila është në punë që nga muaji shtator i vitit 2006, me vendim definitiv. Punësimi i znj. C, është kryer sipas ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, Neni 72, pika 5, paragrafi 2, ku përcaktohet: “Personeli mësimdhënës që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar në mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, gjuhëve të huaja dhe fizikulturës, dhe që ka fituar shkallët e kualifikimit, ruan vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për plotësimin e dijeve që lidhen me profesionin.

Në Shkollën 9-vjeçare “Lekë Çokaj”, Cërnice orët e edukimit fizik i janë caktuar mësuesit të gjimnazit “Asim Vokshi”, z. A.B, për të plotësuar ngarkesën mësimore, duke qenë mësues i sistemit me emërim definitiv. Z. A.B ka pranuar të paguhet nën normë për të mos shkuar te shkolla “Lekë Çokaj” për arsye largësie. Dhe sot ky mësues paguhet me 14 orë në javë. 9 orët e mësimit të

mbetura të pa mbuluara në shkollën “Lekë Çokaj”, i kanë kaluar dy mësuesve për plotësim norme. (Në këtë shkollë ka 3 klasa të AMU, prandaj janë 9 orë edukim fizik).

- Në lidhje me Pikën 2.

E.P është mësuese e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, e renditur e dyta për vitin shkollor 2024-2025, në profilin Edukim Fizik, me 42.5 pikë, prandaj nuk renditet në një vend me dy kandidatët e tjerë pasi ka qenë e pajisur me licencën përkatëse. Me kërkesën e saj është renditur në tabelën e punësimeve jashtë portalit, pasi këtë vit shkollor lista e portalit “Mësues për Shqipërinë” ka ardhur me vonesë, në muajin tetor 2024.

Bazuar në Udhëzimin e MAS, nr. 8, datë 03.05.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe të administrimit të Portalit “Mësues për Shqipërinë”, vlerësimi i mësuesve kandidat bëhet sipas shtojcës 1, të këtij udhëzimi.

Mësuesi R.N.

Nr.	Dokumentacioni i vlerësuar	Vlera	Pikë
1	Nota mesatare e studimeve të larta (0.5-10 pikë)	6.5	1.5
2	Kategoria e kualifikimit (0-5 pikë)	0	0
3	Dëshmi të gjuhës së huaj (0-2 pikë)	Nuk ka	0
4	Certifikata trajnimesh me kredite (0-3 pikë)	Mbi 3 kredite	3
5	Përvoja në punë (0-10 pikë)	8 vite	4
	Shuma e pikëve		8.5 pikë

Mësuesi Znj. A.A.

Nr.	Dokumentacioni i vlerësuar	Vlera	Pikë
1	Nota mesatare e studimeve të larta (0.5-10 pikë)	6.9	2
2	Kategoria e kualifikimit (0-5 pikë)	0	0
3	Dëshmi të gjuhës së huaj (0-2 pikë)	Nuk ka	0
4	Certifikata trajnimesh me kredite (0-3 pikë)	0	0
5	Përvoja në punë (0-10 pikë)	2 muaj	0.1
	Shuma e pikëve		2.1 pikë

Sqarim: Vlerësohen vetëm certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucionet në varësi të MAS ose nga agjencitë trajnuese të akredituara nga MAS. Ndërsa tek përvoja në punë, llogaritet vetëm ajo në arsim.

Bazuar në Udhëzimin e MAS, 8, datë 03.05.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe të administrimit të Portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, pika 8, përcakton se: “Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga Komisioni për

Vlerësimin Psiko-social të Punonjësve Arsimorë dhe punonjësve të tjerë, në institucionet arsimore parauniversitare”.

ZVAP Tropojë bazuar në aktin sipërcituar, nuk mund të kryejë vlerësim tre mujor për punonjësit mësimor të kontraktuar jashtë listave të portalit, por vetëm për kandidatët e portalit që kanë përzgjedhur vende vakante sipas procedurave të përcaktuara në udhëzim.

- Në lidhje me pikën 3:

Shpjegime dhe bazën ligjore në të cilën mbështetet ZVAP Tropojë, lidhur me një akt emërimi si mësuese jashtë portali në shkollën “Hoxhë Zogu”.

Marrëdhënia e punësimit ndërmjet punëmarrësit znj. A.A dhe punëdhënësit, drejtorit të shkollës “Hoxhë Zogu”, është formalizuar me kontratë me afat të caktuar, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe Kodit Civil. (neni 659 dhe 660)

Modeli i kontratës me afat të caktuar me punonjës in mësimor, është model kontrate që përdoret nga të gjithë mësuesit që punojnë në sistemin arsimor parauniversitar, në çdo zyrë arsimore vendore. Ndërsa përsa i përket, aktit të emërimit të kërkuar nga znj. A.A, sqarojmë se ankuesja do emërohet mësuese definitive kur të plotësojë kushtet ligjore. Plotësimi i kushteve ligjore nga ana e ankueses, si: licenca, portali, zgjedhja e vendit të punës me afat të pacaktuar, kalimi në vlerësimin psiko-social, do jenë shkak për punëdhënësin, që të emërojë mësuese definitive, znj. A.A.

- Në lidhje me pikën 4, 5, 6:

Shpjegime se pse znj. A.A nuk trajtohet financiarisht si mësuese në AML.

Znj. A.A disponon ngarkesë mësimore të barabartë në dy nivelet arsimore, konkretisht 11 orë në AML dhe 11 orë në AMU.

Shpjegim i praktikës së ndjekur nga ZVAP Tropojë: Para fillimit të çdo viti shkollor, drejtuesit e shkollave bazuar në programin mësimor, numrin e klasave, hartojnë nevojat që ka shkolla për mësues sipas profileve dhe cikleve dhe mbi këtë bazë bëhet ndarja e mësuesve të AML, AMU dhe AF. Konkretisht në rastin e shkollës “Hoxhë Zogu”, në AML janë planifikuar 4 mësues (4 profilet kryesore: Gjuhë e letërsi, matematikë-fizikë, kimi-biologji dhe histori-gjeografi) dhe drejtori si AML, 6 mësues të AMU dhe 2 mësues të AF. Duke qenë se lënda e Edukimit Fizik ka 11 orë në AMU+AF dhe 9 orë me AML (3 klasë nga tre orë) çdo vit mësuesi i Edukimit Fizik është llogaritur si mësues i AMU-së. Ndërsa dy orët e tjera në AML (një në klasë 11 dhe një në 12-tën) janë me zgjedhje dhe zgjedhja e tyre varet nga kërkesat e nxënësve dhe mundësinë që ka shkolla për të afruar mësues me arsim përkatës. (Si e tillë ka vite ku në AML janë vetëm 9 orë). Kjo ka qenë një ndarje dhe në vitet e tjera shkollore, e cila mund të verifikohet lehtësisht te shpërndarja e ngarkesës mësimore. Pra nuk është një praktikë e këtij viti për të bërë diskriminim ndaj askujt. Theksojmë se kjo është një praktikë e ndjekur nga ne, në të gjitha institucionet arsimore dhe nuk kemi pasur asnjë rast të pagesës së mësuesve AMU+AML, sipas ndarjes së ngarkesës mësimore.

Problematika e trajtimit financiar të znj. A.A është trajtuar administrativisht nga Inspektorati i Punës Kukës, i cili është bazuar në Procesverbalin e Inspektimit me nr. ISHPSHSH-01-2025-000066-2, datë 27.03.2025, shkresës me nr. 162, datë 07.03.2025, “Kthim përgjigje ankueses” dhe emailit të datës 18.03.2025, drejtuar Drejtorisë Rajonale Dibër, “Përgjigje kërkesës për interpretim”, të shkresës së DRAP Lezhë “Për zbatim”, znj. A.A, mësuese e lëndës edukim fizik në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Hoxhë Zogu”, Zogaj, e cila disponon ngarkesë mësimore me 11 orë në AMU dhe 11 orë në AML.

- Në lidhje me pikën 7, 8.

Në ZVAP Tropojë nuk kemi mësues të tjerë të cilët paguhen me pagë mikse. Bazuar referimeve të Inspektoratit të Punës, nëse gjatë viteve mësimore në vazhdim do të kemi raste të tilla, ZVAP Tropojë do të marrë masa për zbatimin e Nenit 115, të Kodit të Punës në trajtimin financiar të tyre. Me pagat e muajit mars 2025, nga ana e ZVAP Tropojë, janë përllogaritur dhe shlyer të gjitha detyrimet financiare të papaguara që rrjedhin nga kontrata e punës me afat të caktuar me nr. 6, datë 11.09.2024. Znj. Znj. A.A me pagën e muajit mars 2025, ka marrë edhe diferencën që nga data 11.09.2024, kur është punësuar, deri me 31.03.2025, duke u llogaritur për të gjitha ditët e punës në shumën 5.781 lekë.

- Në lidhje me pikën 9.

ZVAP Tropojë ka zbatuar me përpikëri vendimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës, si dhe shkresën nr. 392/1, datë 19.03.2025, të DRAP Lezhë “Për zbatim”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i*

dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën e saj për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për tu punësuar si mësuese e lëndës së edukimit fizik, në një nga shkollat e ZVAP Tropojë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Mbështetur në informacionin e administruar, znj. A.A, ka përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në programin “Edukim Fizik dhe Sporte”, nuk është e licencuar si mësuese dhe nuk është pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Ankuesja në periudhën shtator 2024, ka aplikuar në ZVAP Tropojë, për tu punësuar si mësuese jashtë portali. Me email-in datë 10.09.2024, ora 16.26, ZVAP Tropojë ka njoftuar ankuesen për tu paraqitur në mjediset e shkollës “Hoxhë Zogu”, Zogaj, në datë 11.09.2024, për punësim të kandidatëve jashtë portalit, në profilin edukim fizik.

Në datë 11.09.2024, mes shkollës “Hoxhë Zogu” dhe ankuses është lidhur Kontrata individuale e punës me afat të përcaktuar, deri në datë 23.06.2025, në të cilën ankuesja do të ishte mësuese e profilit edukim fizik, do të paguhej me pagën e grupit të I (parë), shkalla e kualifikimit 0 (zero), vështirësi për largësi 2.700 lekë.

- *Lidhur me pretendimin e ankuses, për procedurën e ndjekur për emërimin e saj si mësuese.*

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri mori në analizë legjislationin sa i përket pranimit dhe emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Në ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Neni 54; 1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) c)..... ç) menaxhimin e personelit.....3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a)..... b)..... c) punëson mësues me kohë të plotë ose të pjesshme dhe mësues ndihmës, me fonde të siguruar nga institucioni, sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit dhe Ministrit të Financave.....”.

Në nenin 57, të ligjit 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Mësuesi në institucionin arsimor duhet të ketë fituar diplomën e mëposhtme në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të: a)..... b) Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare. 2. 3. Diplomati e njëvlershme me diplomati e sipërpërmendura përcaktohen me udhëzim të ministrit. 4. Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar në provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”.

Në nenin 60, të ligjit 69/2012 , të ndryshuar, parashikohet se: “1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit...”.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, MAS me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, ka miratuar “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”. Në nenin 42 të kësaj rregullore, parashikohet se: “1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit, që ka të drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit. 2..... 3. Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në IA të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi”, ndërsa në nenin 43, parashikon se: “1. Drejtori ka për detyrë të organizojë shpërndarjen e informacionit në dispozicion të qytetarëve, me të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e shërbimit arsimor të IA-së. 2. Drejtori, pas këshillimit me këshillin e mësuesve: a) vendos formimin dhe ndarjen e klasave dhe merr miratimin e ZVA-së për këtë ndarje, bazuar në udhëzimin përkatës të ministrisë; b) cakton ngarkesën mësimore të mësuesve dhe merr miratimin e ZVA-së për këtë ndarje; c) cakton mësuesit kujdestarë; ç).....; d) përgatit çdo muaj listë prezencën e punonjësve të IA-së”.

Në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. ZVAP identifikon vendet e lira të punës që krijohen në IA në varësi dhe i dërgon në DRAP me e-mail dhe me shkresë zyrtare. Vendet e lira të punës që krijohen në fillim të vitit shkollor dërgohen në DRAP jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i vitit shkollor, ndërsa

gjatë vitit shkollor dërgohen menjëherë. DRAP raporton vendet e lira të punës në AKAP e cila i shpall ato në portalin “Mësues për Shqipërinë.. 3. Për vendet e lira të punës për çdo ZVAP, kandidati njoftohet nga KVD në DRAP, në varësinë e të cilit është vendi i lirë i punës. Njoftimi bëhet përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online. 8. “Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga Komisioni për Vlerësimin Psiko-social të Punonjësve Arsimorë dhe punonjësve të tjerë, në institucionet arsimore parauniversitare” 13/1. Në rast se për pozicionet e lira në ZVAP nuk paraqiten kandidatë të interesuar për tu punësuar në vendet vakante nga lista e portalit të ZVAP dhe DRAP përkatës sipas pikës 11 të këtij kreu, atëherë nga ana e ZVAP vijohet me kandidatë të tjerë të interesuar, të cilët kanë paraqitur kërkesë dhe janë renditur sipas pikëve nga ZVAP. 14. Të gjithë kandidatët e punësuar, sipas pikës 13/1 të këtij kreu në mungesë të kandidatëve nga portali të profilit përkatës, emërohen me kontratë të përkohshme pune, por jo më shumë se një vit shkollor, përfshirë periudhën e nevojshme prej 15 ditësh për përfundimin e dokumentacionit shkollor. Kontrata e përkohshme e punës ndërpritet në momentin e emërimit të një kandidati të profilit përkatës nga portali.....”.

Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, ZVAP Tropojë me shkresën nr. 226, datë 30.08.2024, ka njoftuar hapjen e afatit të aplikimeve për punësim për kandidatët që nuk janë pjesë e portalit Mësues për Shqipërinë, duke i informuar kandidatët se dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohet me email, në formë elektronike nga data 30.08.2024 deri në datë 05.09.2024.

Referuar njoftimit të sipërcituar, ankuesja ka aplikuar për tu punësuar duke dërguar dokumentacionin e kërkuar me formularin datë 02.09.2024.

Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, ZVAP Tropojë me Urdhrin nr. 20, datë 02.09.2024, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit Ad-Hoc, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për mësues. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se nga drejtuesit e shkollave dhe nga ZVAP Tropojë, janë identifikuar dhe shpallur dy vende në profilin edukim fizik, për vitin shkollor 2024-2025.

Lidhur me pretendimin e ankueses se nuk është shpallur vendi i mësuesit të edukimit fizik, në shkollën “Oso Dauti”, rezulton se lëndën e edukimit fizik e mbulon mësuesja Gj.Ç, e cila në vitin 2004-2005, është diplomuar në shkollën e mesme “Havzi Nela”, dega pedagogji. Referuar librezës së punës nr. 130/9, lëshuar nga Zyra Arsimore Tropojë, rezulton se mësuesja Gj.Ç, ka filluar punë si mësuese në Shkollën e Mesme të Bashkuar Llugaj, në datë 01.04.2006. Referuar Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023, të MAS “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesës mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, mësuesja Gj.Ç, nuk plotëson kriterin e profilit të kërkuar si mësuese për lëndën edukim fizik, por bazuar në nenin 72, pika 5, paragrafi 2, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, ku parashikohet se: *“Personeli mësimdhënës që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar në mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar shkallët e kualifikimit, ruan*

vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për plotësimin e dijeve që lidhen me profesionin”, dhe duke pasur një përvojë 19 vjeçare në mësimdhënien e lëndës së edukimit fizik, drejtuesit e shkollës dhe të ZVAP Tropojë, në vite nuk e kanë shpallur si vend të lirë pune, atë pozicion. Pra, rezulton se mësuesja Gj.Ç është mësuese definitive dhe drejtuesit e shkollës dhe të ZVAP Tropojë, në vite nuk kanë identifikuar dhe shpallur vendin e mësuesit të edukimit fizik në shkollën “Oso Dauti” Llugaj dhe nuk rezulton se vetëm znj. Sh.B, në pozicionin si Drejtore e ZVAP Tropojë, nuk ka identifikuar dhe shpallur vendin e mësuesit të edukimit fizik në shkollën Llugaj. Gjithashtu, dhe vendi i punës në shkollën “Lekë Çokaj”, nuk është pozicion me ngarkesë të plotë mësimore (22 orë), që duhej të shpallej si vend i lirë pune nga shkolla, por është pozicion me ngarkesë të pjesshme mësimore, prej 9 orësh, pozicion i cili ka qenë i planifikuar për tu mbuluar nga mësuesi i gjimnazit “Asim Vokshi” z. A.B.

Mbështetur në provat e administruara, në datë 03.09.2024, në faqen e Facebook, ZVAP Tropojë, bazuar në kërkesat e identifikuara nga institucionet arsimore, ka publikuar *“Vendet e lira që shpallen për lëvizjen paralele 2024-2025”*. Për profilin edukim fizik, janë shpallur dy vende, një në SHMB “Hoxhë Zogu”, Zogaj dhe një në SHMB “Murat Paci”, Pac.

Referuar procesverbalit nr. 227/1, datë 06.09.2024, rezulton se Komisioni Ad-Hoc i ZVAP Tropojë, ka bërë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për mësues. Nga renditja e kandidatëve për mësues në profilin edukim fizik, rezulton e renditur e para, kandidatja e licencuar dhe që ka marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, znj. E.P, i dyti z. R.N dhe e treta znj. A.A.

Referuar informacionit të dërguar nga ankuesja me email-in datë 04.12.2024 dhe deklaratimit gjatë seancës dëgjimore, rezulton se ankuesja ka marrë dijeni nëpërmjet facebook-ut të ZVAP Tropojë, për publikimin e dy vendeve të lira për mësues të edukimit fizik dhe ka dorëzuar në ZVAP Tropojë, dokumentet që kërkoreshin për aplikimin për mësues.

Në përfundim të zënies së vendeve të punës, pas fazës së lëvizjes paralele dhe emërimeve sipas portalit, përsëri kanë rezultuar dy vende për mësues të lëndës edukim fizik, për fazën e emërimeve për mësues jashtë portalit.

Referuar pikës 4 të kreut IV, të Udhëzimit 8/2024, në të cilin parashikohet se kandidati i cili është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën të zgjedh i pari vendin e lirë të punës, rezulton se vendi i punës në shkollën “Murat Paci” Pac, me email-in datë 09.09.2024, ora 20.17, i është ofruar mësueses E.P, e cila ishte e renditur në vend të parë, me 5.5 pikë, e cila po nëpërmjet email-it, ka pranuar vendin e punës në shkollën “Murat Paci”. Ndërkohë kandidati i rradhës i renditur, z. R.N, me datë 09.09.2024, është njoftuar për tu paraqitur pranë shkollës “Hoxhë Zogu”, gjë të cilën e ka refuzuar me mosparaqitjen e tij⁵.

Në vijim të plotësimit të vendeve të lira të punës, për mësues të lëndës edukim fizik, ZVAP Tropojë me email-in datë 10.09.2024, ora 16.26, ka njoftuar znj. A.A, që në datë 11.09.2024, duhej të paraqitej në mjedidet e SHMB “Hoxhë Zogu”, Zogaj, për zhvillimin e procedurave për punësimin

⁵ Referuar informacionit të dërguar nga ZVAP Tropojë, me email-in datë 02.07.2025.

e kandidatëve jashtë portalit. Në email është informuar dhe se: “... Në rast të mosparaqitjes suaj në orarin e caktuar, në SHMB “Hoxhë Zogu”, për përzgjedhjen e vendeve të punës do të konsiderohet refuzim dhe jemi të detyruar të vazhdojmë me kandidatin që është renditur poshtë jush. Ju sqarojmë se lidhja e kontratës tuaj mund të ndryshojë me ardhjen e listës së Portalit 2024, me kandidatë me pikë më të larta se ju”.

Rezulton se ankuesja, në datë 11.09.2024, është paraqitur në shkollën “Hoxhë Zogu”, dhe mes palëve është lidhur kontrata e punës me afat të përcaktuar, nr. 6, datë 11.09.2024 dhe znj. A.A duhet të zbatonte kushte e kontratës, deri në datë 23.06.2025.

Referuar njoftimeve për zgjedhjen e vendit të punës, të bërë nga ZVAP Tropojë, për njoftimin e mësuesve jashtë portalit, rezulton se orari i njoftimit dhe teksti i email-it, është pothuajse i njëjtë për të gjithë njoftimet e mësuesve: E.P, F.Gj, F.M, A.Z dhe E.M. Pra, rezulton se ankuesja është trajtuar në mënyrë të barabartë me kandidatët e tjerë, si për orarin e njoftimit, ashtu dhe për përmbajtjen e tij, dhe nga ana e ZVAP Tropojë nuk rezulton të jetë mbajtur një qëndrim i pabarabartë për znj. A.A.

Me email-in datë 10.09.2024, znj. A.A i është drejtuar ZVAP Tropojë dhe DRAP Lezhë, në të cilën ka kërkuar transparencë për listën e kandidatëve për mësues jashtë portalit dhe vlerësimit të pikëve.

ZVAP Tropojë me shkresën nr. 259, datë 04.10.2024, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke e informuar se: “... Dosjet e aplikantëve janë vlerësuar në mënyrë profesionale dhe për të ruajtur privatësinë e tyre ju është vënë nga një kod, janë publikuar edhe në faqen zyrtare të ZVAP: Me kodin 202426, Znj. A.A i është llogaritur: 1. Mesatarja e bachelorit + master profesional/ sipas udhëzimit dhe shtojcës nr. 2; 2. Nuk ka dëshmi kualifikimi; 3. Gjuhë e huaj, nuk ka sjellë dokument; 4. Certifikatat nuk janë me kreditë; 5. I është llogaritur vjetërsi në bazë të vërtetimit të kontributeve të shkarkuar nga e-albania në dosjen e saj.

Çdo element i vlerësueshëm në dosjen e saj është parë me korrektësi. Renditja e saj është bërë në grupin e kandidatëve me të njëjtin nivel diplome. Personi që ka zgjedhur shkollën “Murat Paci” është me licencë”.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, lidhur me procedurat për emërimin e një mësuesi në një vend pune, rezulton se kriteri i vetëm për emërimin e një kandidati si mësues, për lëvizje paralele, sipas portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe jashtë portalit, është renditja e kandidatëve sipas vlerësimit me pikë dhe nuk ka të parashikuar kriterë të tjera.

- Lidhur me pretendimin e ankueses për transportin e mësuesve.

Transporti i punonjësve arsimorë rregullohet sipas VKM nr. 119, datë 01.03.2023, “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, në të cilën parashikohet si më poshtë:

“1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e: a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor,

arsimit bazë dhe të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km;..

Pika 3. DRAP dhe ofruesit e arsimit profesional publik prokurojnë me fonde publike shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, sipas linjave në përbërje/pjesë të rrjetit të linjave të transportit rrethqytetas, të miratuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Pika 4. Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit rrethqytetas, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga DRAP, me autorizimin e kësaj të fundit, ZVAP-ja siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të IAP-së publike përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, të kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë të IAP-së publike, përfitues ose nëpërmjet shërbimit postar, vetëm për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, deri në përfundim të vitit buxhetor. Ndërsa tarifat e transportit rrugor janë sipas Vendimit nr. 92, datë 21.02.2024 sipas distancave në kilometra (km).

6. Punonjësit arsimorë, që përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit të siguruar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë kompensim mujor të diferencuar, sipas paragrafit 4.a), të pikës 4, të VKM nr. 175/2017, të ndryshuar, për distancat, si më poshtë vijon: a)..... b)..... c) në masën 2700 lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm, deri në institucionin arsimor publik parauniversitar është në distancën mbi 20 km deri në 50 km. ...”.

Referuar informacionit të deklaruar nga ZVAP Tropojë, rezulton se në asnjë shkollë që mbulohet nga ZVAP Tropojë nuk ofrohet shërbimi i transportit të punonjësve arsimorë, për arsye të mosrealizimit të prokurimit publik për këtë shërbim. Referuar kontratës individuale të punës së ankueses, rezulton se ajo kompensohet në vlerën 2700 lekë, për transportin, sipas parashikimit të VKM-së, sipërcituar, pra deri në 50 km⁶. Pra, rezulton se nuk kemi një trajtim të pabarabartë të ankueses nga ana e ZVAP Tropojë, lidhur me transportin e punonjësve arsimorë, pasi ky shërbim nuk ofrohet për asnjë mësues.

- Lidhur më pretendimin e ankueses, për pagesën si mësuese e AMU+AML.

Pagesa e punonjësve mësimorë rregullohet sipas VKM nr. 425, datë 26.06.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”. Në pikën 2 të kësaj VKM-je përcaktohet se: “2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi janë, si më poshtë: a) Për punonjësit mësimorë: i. Paga për pozicionin, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune; ii. Shtesa e

⁶ Referuar aplikacionit Google map, distanca nga Bashkia Bajram Curri në shkollën “Hoxhë Zogu” Zogaj, është 48 km.

nivelit të kualifikimit,..... iii. Shtesa për vjetërsi në punë, iv. Shtesa për kategorinë e kualifikimit, v. Shtesa për natyrë të veçantë pune..... ”.

Në lidhjen 1, të kësaj VKM-je përcaktohet paga për pozicionin, në të cilin përcaktohet: 8. Mësues në shkollat e arsimit të mesëm të lartë: 73.000 lekë; 10. Mësues në arsimin e mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare: 71.000 lekë.

Në vendimin e sipërcituar nuk ka të parashikuar, rastet kur mësuesi ka ngarkesë të barabartë në AMU dhe AML.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se znj. A.A disponon ngarkesë mësimore të barabartë në dy nivelet arsimore, konkretisht 11 orë në AML dhe 11 orë në AMU. Drejtori i shkollës bazuar në praktikën e viteve të kaluara, në periudhën kur bëhet planifikimi i shpërndarjes së ngarkesës mësimore për mësuesit, ka planifikuar ngarkesën e mësuesit të lëndës edukim fizik, si mësues i ciklit AMU. Ky planifikim është bërë përpara se znj. A.A të nënshkruante kontratën e punës me shkollën.

Znj. A.A, problematikën e trajtimit të saj financiar e ka bërë objekt të ankesës pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Dibër, Inspektoriatit të Punës Kukës.

Inspektoriatit Shtetëror të Punës, me Vendimin përfundimtar të inspektimit, nr. ISHPSHSH-D1-2025-000066-5, datë 27.03.2025, ka vendosur: *“Të merren masa nga ana e subjektit dhe të sigurohet që punëmarrësja znj. A.A të trajtohet financiarisht me gjysëm norme AML dhe gjysëm norme AMU, në raport me ngarkesën mësimore që mbulon. Të realizohet menjëherë”*.

Në zbatim të inspektimit të Inspektoriatit të Punës, DRAP Lezhë me shkresën nr. 392/1, datë 19.03.2025, ka kërkuar nga ZVAP Tropojë që:

1. ZVAP Tropojë si punëdhënës të paguajë, znj. A.A, bazuar përcaktimeve të nenit 115, pika 1 të Kodit të Punës⁷ dhe VKM nr. 425, datë 26.06.2024.
2. Të përlllogariten dhe të shlyhen detyrimet financiare të paguara ndaj znj. A.A që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës me afat të caktuar nr. 6, datë 11.09.2024.

Në zbatim të vendimit të Inspektoriatit të Punës dhe kërkesës për zbatim të DRAP Lezhë, ZVAP Tropojë ka informuar se me pagat e muajit mars 2025, janë përlllogaritur dhe shlyer të gjitha detyrimet financiare të papaguara për znj. A.A, në shumën 5.781 lekë.

Referuar informacionit të deklaruar nga ZVAP Tropojë, rezulton se nuk ka pasur asnjë rast që ndonjë mësues të jetë paguar sipas ndarjes së ngarkesës mësimore, gjysëm AMU dhe gjysëm AML, dhe se nëse do të ketë në të ardhmen raste të ngjashme, do të marrë masat për pagesën e mësuesve sipas, rekomandimit të Inspektoriatit të Punës.

⁷ “Punëdhënësi paguan punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar për ndonjë nga shkaqet e përmendura në pikë n 2, të nenit 9, të këtij Kodi”.

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Pavarësisht faktit që nga ana e ZVAP Tropojë apo institucioneve arsimore nën juridiksionin e saj, nuk janë shpallur një pjesë e orëve të lira të profilit të edukimit fizik, nuk u konstatua që ky veprim apo mosveprim i tyre të jetë bërë me qëllim përjashtimin e ankueses nga e drejta për tu punësuar, pasi ankuesja ishte shpallur fituese nga ana e ZVAP-së dhe kishte nënshkruar kontratën e punës.
- Nga ana e ZVAP Tropojë, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe kriteret, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për publikimin e vendeve të punës, vlerësimit të dosjes së ankueses dhe renditjes së mësuesve sipas vlerësimit të tyre.
- Nuk rezultoi se në ZVAP Tropojë, të kishte pozicione të tjera të lira me ngarkesë të plotë, për mësues të profilit edukim fizik.
- Ankuesja është trajtuar në mënyrë të barabartë me mësuesit e tjerë, përsa i përket orës dhe përmbajtjes së njoftimit për vendin e lirë të punës, nga ana e ZVAP Tropojë.
- Ankuesja nuk është vendosur në kushte të pafavorshme nga ana e ZVAP Tropojë, lidhur me transportin e punonjësve mësimorë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se ZVAP Tropojë, Drejtore Znj. Sh.B, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm⁸.

⁸ Për analogji citojmë vendimet: nr. 150, datë 11.08.2021 dhe nr. 86, datë 16.05.2022.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një trajtim të pafavorshëm nga ana e ZVAP Tropojë, Drejtore Znj. Sh.B, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se ZVAP Tropojë, Drejtore Znj. Sh.B, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuseses Znj. A.A, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tropojë, Drejtore znj. Sh.B.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA